



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istok
Istok Municipality

12Nr.34/22

**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Direkcija za Kulturu Omladinu i Sport
Department of Culture Youth and Sports**

Istog, 30.05.2022

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komuna Istog në bazë të rregullores (K.IS) 42/2014 për ndarjen e Subvencioneve si dhe në bazë të rregullores MF – Nr. 04/2017 për kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve shpallë:

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të, OJQ-ve dhe Individëve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

1. Komuna e Istogut u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Komunën e Istogut dhe programi i punës i cili është i fokusuar në fushën e sportit, kulturës dhe rinisë si dhe Individëve të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

2. OJQ-të si dhe Individët në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për aktivitetet e mëposhtme:

SEKTORI I RINISË

- Aktivitete rinore
- Edukimi joformal (Fushata ndërgjegjësuese, trajnime, seminare, tryeza të rrumbullakëta, konferenca)
- Organizimi i javës së rinisë, dita ndërkombëtare e rinisë
- Aktivitete për personat me aftësi të kufizuara
- Promovimi i talentëve të rinjë
- Aktivitete me karakter garues; garat e diturisë
- Aktivitete rekreative
- Përkrahje individuale

SEKTORI I KULTURËS

- Promovimi i librave
- Botimi i librave/shkrimeve letrare, manifestime letrare
- Festivalet (muzikë, folklore)
- Ekspozita me Fotografi(Art në hapësira të hapura)
- Trashëgimi Kulturor
- Java e Kulturës
- Data historike dhe kulturore (manifestim të datave historike, shënim të festave kombëtare, datave të rëndësishme për qytetin e Istogut)
- Eksplorim të bukurive natyrore
- Përkrahje individuale.

SEKTORI I SPORTIT

- Klubet Sportive
- Masovizimi i sportit
- Organizime sportive me karakter garues
- Përkrahja e sportit shkollor
- Aktivitete sportive për personat me aftësi të kufizuara si dhe
- Përkrahja individuale .

3. Dokumentet kryesore të cilat ofruesi i mbështetjes financiare do të kërkojë të dorëzohen nga OJQ përfshijnë:

OJQ-të duhet ti sjellin këto dokumentacione:

- Kopjen e letërnjoftimit të drejtuesit të OJQ-ës apo dokument tjetër identifikues valid;
- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;
- Certifikata e nr. fiskal;
- Vërtetimin/Konfirmimin e llogarisë bankare të lëshuar nga banka përkatëse (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
- Vërtetimin që OJQ, nuk ka obligime tatimore (nga ATK)
- Adresën e OJQ-së (selia);
- Projekt propozimin së bashku me Aplikacionet (Të dhënat e organizatës dhe Projekt propozimi si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme Formularët e paraparë sipas thirrjes);
- Dëshmi nga ATK që organizata është active
- OJQ-të që nuk e kanë dorëzuar raportin financiar dhe narrativ për mbështetjen e vitit të kaluar ta dorëzojnë atë së bashku me dokumentacion

Klubet Sportive duhet ti sjellin këto dokumentacione:

- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së (Klubit);
- Certifikata e nr. fiskal;
- Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
- Kopjen e letërnjoftimit/ pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së;
- Vërtetimin që OJQ/klubi/shoqata nuk ka obligime tatimore (nga ATK)
- Vendimin e regjistrimit të klubit
- Projekt propozimin si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme formularët e paraparë sipas thirrjes);
- Dëshmi nga ATK që organizata është active
- Klubet që nuk e kanë dorëzuar raportin financiar dhe narrativ për mbështetjen e vitit të kaluar ta dorëzojnë atë së bashku me dokumentacion

Aplikuesit individual duhet ti sjellin këto dokumentacione:

- Kopjen e letërnjoftimit apo dokument tjetër identifikues valid;
- Certifikatën e vendbanimit;
- Projekt propozimin si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme Formularët e paraparë sipas thirrjes;
- Vërtetimin/Konfirmimin e llogarisë bankare të lëshuar nga banka përkatëse; (pas publikimit të rezultateve)
- Dëshmia që individi nuk është nën hetime;(pas publikimit të rezultateve)

KRITERET PËR PJESËMARRJE NË THIRRJEN PUBLIKE PËR SUBVENCION, SI DHE KRITERET E PRANUESHME

- Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, Klubet sportive të cilat janë të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Istogut para datës së publikimit të thirrjes publike;
- Individ me vendbanim në komunën e Istogut dhe realizojnë aktivitetin e tij/saj në komunën e Istogut;
- Individët, Klubet Sportive, OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën për të cilën aplikojnë në Kulturë, në Rini apo në Sport;
- Individët, Klubet sportive, OJQ-të të cilat veprojnë në Komunën e Istogut dhe realizojnë aktivitetin e tyre në Komunën e Istogut;
- Individët, Klubet sportive, OJQ-të mund të subvencionohen vetëm një herë brenda vitit për të njëjtin aktivitet
- Individët, Klubet sportive, OJQ-të të cilët nuk kanë përmbyllë raportin e subvencioneve të viteve paraprake nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Istogut në këtë thirrje;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime të tjera të financimit për të njëjtat aktivitete brenda të njëjtit vit fiskal,

- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;
- Klubet përkrahen në: (Kotizimi I Klubeve për gara Kampionale, Shpenzimet për Transport në gara, shpenzime për personat zyrtar në gara referë dhe delegate, licencimi I lojtarëve dhe trajnerëve, ushqim për lojtarë të Klubit për gara kampionale, uji për lojtarë për gara kampionale)
- Nuk subvencionohen qiraja për zyre, inventari, komunalit si dhe nuk përkrahen Transferet e Lojtareve, rekuizitat sportive, pagat e lojtareve, pagat e stafit etj;
- Nuk subvencionohen sportistët individualisht të cilët janë të organizuar brenda klubeve të cilat subvencionohen;
- Klubet të cilat janë të regjistruara si klube sportive në Komunën e Istogut, të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike.
- Klubet Sportive nuk mbështeten me kërkesën e derivateve gjatë vitit por duhet të planifikuar në programin e punës – vijën buxhetore
- Si dhe kufizimet e parapara me rregulloren për subvencione në Komunën e Istogut
- Nuk mbështeten librat e publikuara(shtypura);
- Nuk mbështeten financiarisht aktivitete që do të realizohen përmes internetit (Online).
- Përparësi të mbështetjes financiare kanë projektet inovative dhe tradicionale, promovuese në arenën ndërkombëtare.
- Organizatat jo-qeveritare dhe personat fizik mund të aplikojnë vetëm me nga një projekt në kuadër të Kulturës, Rinisë dhe Sportit i cili do të përfshijë dhe kontribuojë në promovimin e aktiviteteve të parapara me pikën 2 të kësaj thirrje publike.

5. Shuma minimale e mbështetjes financiare për një projekt individual është 100-500.00euro, ndërsa shuma maksimale për OJQ është 1500 euro, ndërsa tek Klubet profesionale shuma maksimale është në bazë të numrit të aplikacioneve, mundësive financiare si dhe shpenzimeve që mbulohen tek kriteret e pranueshme sipas thirrjes.

Shuma totale e thirrjes: 40.000 euro

6. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është së paku 15 ditë pune nga dita e publikimit të thirrjes publike përkatësisht dita e fillimit është 30.05.2022, ndërsa dita e fundit për dorëzimin e propozimit është me datën, 24.06.2022 ora: 16:00.

7. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrimin e organizatave joqeveritare të Republikës së Kosovës, në Komunën e Istogut.

Periudha e zbatimit të projektit është deri në fund të vitit 2022.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-të duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk është në hetime për vepra penale si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të pa paguara, nëse është e aplikueshme.

Të njëjtat dëshmi duhet t'i dorëzoj edhe personi fizik i cili është përfitues i mbështetjes financiare.

8. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë me kopje fizike, të cilët janë në dispozicion në faqen e internetit të komunës së Istogut.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me post ose personalisht, në zarf të mbyllur në zyrën e QSHQ (qendra për shërbim me qytetarë) në adresën "Komuna Istog, rruga Fadil Ferati, 31000".

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënja e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në rregulloren për subvencione. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë të pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

9. Të gjitha qështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, por jo më vonë se tetë(8) ditë para mbylljes së thirrjes publike, duke dërguar email në adresën eliane.blakaj@rks-gov.net

RAPORTI I AKTIVITETEVE PËR VITIN 2022

Nr rendor	Data e realizimit të aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit (sqaro pse është mbahet, kush ka marr pjesë, çfarë rezultateve ka siell)	Kostoja (shëno vlerën e kostos)	Vendi (ku është realizuar)	Orari	Fushëveprimtaria (përshkruaj llojin e aktivitetit)

RAPORTI I SHFRYTËZIMIT TË DERIVATEVE PËR VITIN 2022

NR	DATA	VENDI I NGJARJES	VENDI I ARRITJES	KILOMETRAZHA	SASIA	NENSHKRIMI
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						
14						
15						
16						

Nëshkrimi dhe vula e OJQ-së-
INSTITUCIONI



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istok
Istok Municipality

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Ftesë publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve për projektet Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Aplikacion për projekt

Data e publikimit të ftesës: 30 maj 2022

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit: 24 qershor 2022

Ju lutemi para se të plotësoni Formularin për ftesë publike për projektet në sektorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për OJQ si dhe për Individët për vitin 2022. Lexoni me kujdes udhëzimet për plotësim.

Informatat duhet të jenë të sakta, të plota, në mënyrë që të japin detaje të mjaftueshme për të kuptuar qartë projekt-propozimin.

Ju lutemi plotësoni formularin duke përdorur kompjuterin.

Emri i projektit: _____

Emri i aplikuesit: _____

I. INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR APLIKUESIN E PROJEKTIT			
INFORMACION BAZË PËR ORGANIZIMIN E APLIKUESIT			
1. Emri i Organizatës			
2. Adresa (rruga dhe numri)			
3. Kodi postar dhe selia	4. Rajoni		
5. Emri i bartësit të projektit, adresa, e-mail dhe funksioni aktual			
6. Nr. Tel.	7. Nr. Tel. Mob.		
8. Fax			
9. Adresa postare			
10. Faqja e internetit			
11. Viti i themelimit			
12. Data e regjistrimit në regjistrin e OJQ-ve	13. Numri i Regjistrimit të OJQ-së		
14. Regjistruar në (emri i organit të regjistrimit)			
15. Numri llogarisë bankare përfshirë IBAN			
16. Numri fiskal i OJQ-së			
17. Lloji i OJQ-së (shoqatë/fondacion)			
18. Objektivat e krijimit në përputhje me statutin e OJQ-së			
19. Qëllimi dhe fushëveprimi i Aplikantit			
20. Numri i përgjithshëm i (vendoset numëri)	Anëtarëve		
Nga ta (vendoset numëri)	Individ	Persona juridik	
21. Pjesa e punës vullnetare në organizatë			
a) numri i atyre të cilët punojnë vullnetarisht			
b) numri i orëve të punës vullnetare arritur në vitin para shpalljes së thirrjes			
22. A është organizata juaj përfituese e statusit të beneficuar publik	Po.	Jo.	
II. INFORMACION MBI PROJEKTIN			
1. Emri i projektit:			

2. Përmbledhje e projektit (një prezantim i shkurtër i informacionit bazë për projektin në jo më shumë se 50 fjalë)			
3. Kohëzgjatja e implementimit të projektit:			
4. Fusha në të cilën do të implementohet projekti: (sport,kinematografi, teatër, muzikë, arte vizuale, industri kreative, diversitet kulturor dhe dialog, diplomaci kulturore, aktivitete letrare, bibliotekari).			
5. Rajoni gjeografik në të cilin do të implementohet projekti			
a) Republika e Kosovës (nëse projekti implementohet në gjithë territorin e Kosovës			
b) Rajoni/rajonet(tregoni rajonin ose rajonet në të cilat do të implementohet projekti			
c) Komuna/komunat (shëno komunat përkatëse)			
6. Shuma totale e kërkuar për zbatimin e projektit/programit:			
6.1. Shuma totale e kërkuar për financim nga donatorët; në __% e shumës për implementimin e projektit/programit			
6.2. A është shuma e kërkuar apo e siguruar nga burimet publike (institucionet qendrore apo lokale, fondet e Bashkimit Evropian apo nga donatorë të tjerë për zbatimin e këtij projekti (specifiko shumat totale për aplikantët dhe partnerët, nëse keni.			
Po.		Jo.	
Nëse përgjigja e pyetjes së mëparshme është "po" tregoni se sa është shuma financiare e kërkuar/miratuara nga çdo financim i donatorëve (shtoni rreshtat e reja nëse është e nevojshme):			
Nga ata që është kërkuar:		Shuma e fondeve të kërkuara:	
Nga ata që është siguruar		Shuma e fondeve të miratuara:	
7. Tregoni mënyrën se si keni ardhur deri te identifikimi i problemit dhe vlerësimi i nevojave që do të adresoni nëpërmjet këtij projekti.			
8. Përshkruani objektivat e synuara të projektit.			
9. Përshkruani ndikimet e pritshme të projektit			

10. Një përshkrim i detajuar i projektit (max 2500 karaktere)								
11. Cili është grupi i synuar (grupi në të cilin aktivitetet e projektit do të ndikojnë direkt) i përfshirë në projekt, duke përfshirë numrin dhe strukturën e tyre? Si janë ata të përfshirë në këtë projekt?								
12. Përshkruani, aktivitetet kryesore që do të kryhen në kuadër të projektit, bartësit, rezultatet e pritura, periudha e zbatimit të tyre, metodat që do të përdoren në zbatimin e projektit (nëse është e nevojshme shtoni rreshta në tabelën e mëposhtme).								
Aktivitetet	Bartësi	Metodat implementuese	Periudha e implementimit	Rezultatet e pritura				
1.								
2.								
...								
13. Plani i veprimit - kur do të zbatohet aktiviteti dhe organizata/Individi që është përgjegjës/e për zbatimin e tij								
Gjysma e parë e projektit								
Aktiviteti	Muaji i zbatimit	1	2	3	4	5	6	Organizata/Individi përgjegjës/e
...								
Gjysma e dytë e projektit:								
Aktiviteti	Muaji i zbatimit	7	8	9	10	11	12	Organizata/Individi përgjegjës/e
...								
14. Personat përgjegjës për zbatimin e projektit								
a) Udheheqesi/drejtuesi i projektit (shkruani emrin dhe bashkangjitni një CV)								
b) Kontraktuesit, nëse ka (shkruani emrin, përshkrimin e përvojës dhe kualifikimeve të mëparshme)								
15. Ekspert/et, bashkëpunëtorët / e jashtëm të cilët janë								

përfshirë në projekt, nëse (shëno emrin dhe fushat e ekspertizës)	
16. Përshkrim i shkurtër i përvojave, arritjeve dhe aftësitë e organizatës/individit.	
17. Si planifikoni realizimin e aktiviteteve të projektit (në nivel lokal, apo nacional)?	
III. QËNDRUESHMËRIA PROJEKTIT	
Përshkruani planet tuaja që do të sigurojnë qëndrueshmërinë e projektit pas përfundimit të mbështetjes financiare publike dhe pas përfundimit të projektit?	

Emri dhe mbiemri i bartësit të projektit:

(nënshkrimi/vula)

Në _____, _____ 2022.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Skupstina Opštine
Municipal Assembly

Emri i OJQ-së:

Titulli i projektit:

Formulari i buxhetit të ftesës publike				
Plotësoni formularin me kompjuter				
Lloji i kostos	Cmimi per njësi	Buxheti i përgjithshëm i projektit në euro	Buxheti i kërkuar nga DKRS (euro)	
A) Kostot direkte (specifikko shpenzimet që janë të lidhura direkt me projektin)				
1. Burimet Njerëzore				
1.1. PAGAT (specifiko kosto e pagave dhe përfitimeve për punonjësit) Shënim: Ju lutemi jepni emrat dhe mbiemrat e personave që do të paguhen, periudhën për të cilën paguhet tarifa, si dhe titullin e punës				

1.1.3.				
Gjithsej 1.1.				
1.2. Kontratat e shërbimeve				
Shënim: Ju lutemi jepni emrat dhe mbiemrat e njerëzve të cilët do të marrin kompensim për këtë punë				
1.2.3.				
Gjithësej 1.2.			0.00 €	0.00 €
Gjithësej 1. (1.1+1.2.):			0.00 €	0.00 €

2. Udhëtimi (specifiko koston, për shembull, të transportit publik, shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet e akomodimit, medijt për qëllimin e kryerjes së aktiviteteve të projektit)			
2.3. Gjithësej 2.:		0.00 €	0.00 €
mallrat			
3.3. Gjithësej 3.:		0.00 €	0.00 €
4. Kostot e tjera, shërbimet (fushata, trajnimi për përdoruesit kryesorë, kostoja e monitorimit të implementimit të projektit, kostot e tjera që janë të nevojshme dhe të lidhura direkt dhe të nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të projektit dhe të ngjashme.)			

4.4.				
Gjithësej 4.:		0.00 €		0.00 €
B) Shpenzime të tjera direkte të projektit (të specifikohen)				
5.4.				
Gjithsej 5.:		0.00 €		0.00 €
TOTALI (1+2+3+4+5)		0.00 €		0.00 €
6. BURIMET E FINANCIMIT TË TJERA		Shumat e burimeve tjera të financimit		
I. Burimet vetanake				
II. Autoritetet e tjera publike - qendrore				
III. Autoritetet komunale				
IV. Tjera				
TOTALI (I+II+III+IV)		0.00 €		

KOSTOJA E PËRGJITHSHME E PROJEKTIT NGA TE GJITHA BURIMET	0.00 €
--	--------

DEKLARATË MBI FINANCIMIN E DYFISHTË

Deklaroj se:

Aplikuesi:

(Emri i OJQ-së)

Përcakto njërin nga opsionet:

A) nuk ka pranuar

financim për projektin apo programin aplikues nga burime publike, sipas thirrjeve publike të organeve qeveritare, komunave, institucioneve tjera publike, fondeve të BE-së apo fondeve tjera vendore ose ndërkombëtare në vitin aktual kalendarik.

ose

B) ka konkurruar

për financimin e projektit/programit, por procesi i vlerësimit të projekt/programit është ende në proces.

(Emri i institucionit dhe thirrjes publike në të cilën projekti ka konkurruar)

Nën përgjegjësi penale dhe materiale deklaroj se të gjitha informatat e përfshira në deklaratë janë të vërteta, të sakta dhe të plota.

Vendi dhe data:

Emri i plotë dhe nënshkrimin e përfaqësuesit të autorizuar të OJQ-së

DEKLARATË

mbi projektet e financuara nga burimet publike të financimit në vitin 2022
deklarojmë se organizata jonë:

(sheno emrin e OJQ-së)

Vendos "X" në pjesën e deklaratës e cila është adekuate

- ☐ Ka marrë mbështetje financiare për projektet e tyre nga burime publike në vitet 2020/21, sipas thirrjeve publike të organeve qeveritare, komunave, institucioneve tjera publike, fondeve të BE-së apo fondeve tjera vendore ose ndërkombëtare

Emri i projektit	Financuesi <i>Shëno emrin</i>	Shuma e përkrahjes financiare	Viti	Faza në të cilën gjendet projekti: a) I përfunduar b) Duke u implementuar
1.				
2.				
3.				

- ☐ Është në proces të implementimit të projekteve nga burimet publike të financimit, dhe në të njëjtën kohë duke i përmbushur obligimet kontraktuale
- ☐ I ka përmbushur të gjitha detyrimet kontraktuale për mbështetjen financiare të pranuar nga donatorët dhe ofruesit e tjerë të mbështetjes financiare publike
- ☐ Nuk i ka përmbushur të gjitha detyrimet kontraktuale për mbështetjen financiare të pranuar nga donatorët dhe ofruesit e tjerë të mbështetjes financiare publike

Deklarojeni arsyen pse OJQ ka dështuar të përmbushë detyrimet kontraktuale

Vendi dhe
data:

Emri dhe nënshkrimi i
përfaqësuesit të autorizuar